



Pranuar / Doretuar Primjeno/Pridato Received/Delivery	11.10.2023	3 viti god veq	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Hr Prot Br Prot Prot.No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	6509/2023		119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1086/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1086/2023 të datës 16.08.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit Komuna e Drenasit, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datën 10.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Detyrohet Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij Vendimi të nxjerrë akt administrativ lidhur me kërkesën e datës 21.06.2023 të parashtruar nga ankuesja Vlora Gjinovci.
- II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar sipas Akt Emërimit me numër Nr.01 AE.Nr.15-111/01-10795/2023 të datës 12.07.2023 në Komunën e Drenasit në pozitën e punës "Udhëheqëse e Sektorit të Ndërtimit" në Departamentin DIP-Sektor i Ndërtimit. Me datë 21.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër Nr.15/400/29567 tek Udhëheqësja e Zyrës së Personelit, lidhur me kompensimin për punët dhe detyrat shtesë sipas Ligjit të ri të Pagave për periudhën kohore sa ankuesja ka qenë Zëvendësuese e Udhëheqëses së Sektorit të Ndërtimeve sipas Vendimit me numër 01Nr.112/02-693/22 të datës 06.01.2022 të Kryetarit të Komunës së Drenasit.



Ankuesja e pakënaqur me mos nxjerrjen e aktit administrativ nga ana e Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit, më datë 01.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër 01-070/1-37309 në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave në Komunën e Drenasit, për shkak të kompensimit për punët dhe detyrat shtesë sipas Ligjit të ri të Pagave për periudhën kohore sa ankuesja ka qenë Zëvendësuese e Udhëheqëses së Sektorit të Ndërtimeve, ndërsa më datë 11.08.2023 Komisioni i Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik ka nxjerr njoftimin me numër Nr.01-070/01-37309, përmes të cilit ka njoftuar se shpallet jo kompetent lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesja.

Ankuesja pas marrjes së Vendimit të Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik më datë 16.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5688/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se edhe për kundër faktit se ka parashtruar ankesë në Zyrën e Personelit për kompensimin e pagës shtesë për periudhën kohore sa ankuesja ka qenë Zëvendësuese e Udhëheqëses së Sektorit të Ndërtimeve sipas Vendimit me numër 01Nr.112/02-693/22 të datës 06.01.2022 të Kryetarit të Komunës së Drenasit, kjo e fundit nuk ka zhvilluar asnjë hap komform ankesës së ankueses edhe përkundër detyrimit ligjor për nxjerrjen e aktit administrativ.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave, me datën 28.08.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Drenasit, ndërsa Këshilli me datën 04.09.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesën e ankuesit nga kjo e fundit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Me datën 28.09.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 5688/2023 të datës 16.08.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin me numër Nr.01-070/01-37309 të datës 11.08.2023; Ankesën me numër Nr.01-070/1/37309 të datës 01.08.2023; Vendimin për pagesë retroaktive me numër Nr.400/01-30838 i datës 29.06.2023; Ankesën me numër Nr.15-400/01-29567 e datës 21.06.2023; Vendimin me numër NR.112/02-693/22 i datës 06.01.2022; E-mailat e datës 15.06.2023; Akt Emërimit me numrin 01AE.Nr.15-111/01-10795/2023 të datës 12.07.2023; E-mail i datës 16.08.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 28.08.2023; Përgjigje në ankesë e datës 31.08.2023; Akt Emërimit me numrin 01-120-29419 të datës 29.05.2017; Njoftimin me numër 01-120-36327 i datës 03.07.2017; Listën e pagave për muajin prill 2023; Listën e pagave për muajin Mars 2023; Listën e pagave për muajin Maj 2023; Listën e pagave për muajin Qershor 2023; Listën e pagave për muajin Korrik 2023; Njoftimin me numër Nr.01-070/01-37309 e datës 11.08.2023; Listën e pagave për muajin Shkurt 2023; Vendimin me numër Nr.112/02-693/22 të datës 01.01.2022; Konfirmim për transferimin e nëpunësit i datës 20.06.2022; Kërkesë e datës 01.03.2023; Njoftimin me numër 15-400/01-10654 të datës 17.03.2023; Shkresë për DMZP për muajin mars 2023; Diplomë me Nr.690 e datës 25.12.2013; E-mail i datës 06.07.2023; E-mail i datës 15.06.2023; Kërkesë me numër Nr.111/01-10795 e datës 01.03.2023; E-mail i datës 28.08.2023; Pliko e datës 18.08.2023.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 16 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore për detyrimin e organit punëdhënës, respektivisht Udhëheqësen e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit, që ti ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për të vendosur lidhur me ankesën e datës 20.06.2023 të parashtruar nga ankuesja

*sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, bazuar në dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit ka konstatuar se ankuesja është e punësuar në Komunën e Drenasit fillimisht sipas Akt Emërimit me numër 01-120-29419 të datës 29.05.2017 në pozitën „Zyrtare për Ndërtim në Sektorin e Ndërtimit, ndërsa pas përfundimit të procedurës së rekrutimit ngritje në detyrë ankuesja është përzgjedhur si kandidat e suksesshme dhe e njëjta sipas Aktit të Emërimit me numër protNr.01 AE.Nr.15-111/01-10795/2023 të datës 12.07.2023 e ushtron pozitën e punës „Udhëheqëse e Sektorit të Ndërtimit“ në Departamentin DIP-Sektorin i Ndërtimit.

Kolegji bazuar në shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankuesja sipas Vendimit me numër 01Nr.112/02-693/22 të datës 06.01.2022 të Kryetarit të Komunës së Drenasit është caktuar si Zëvendësuese e Udhëheqëses së Sektorit të Ndërtimit deri në zhvillim e proceduarës së rekrutimit për këtë pozitë.

Ankuesja më datë 21.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 15-400/01-29567 tek Udhëheqësja e Zyrës e Personelit në Komunën e Drenasit duke kërkuar kompensim për punët dhe detyrat shtesë sipas Ligjit me numër Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, gjegjësisht pas hyrjes në fuqi të ligjit të lartpërmendur për periudhën kohore sa ankuesja ka qenë Zëvendësuese e Udhëheqëses së Sektorit të Ndërtimeve sipas Vendimit me numër 01Nr.112/02-693/22 të datës 06.01.2022 të Kryetarit të Komunës së Drenasit. Më datë 29.06.2023 Drejtori i Drejtorisë për Infrastruktura Publike në Komunën e Drenasit ka nxjerrë Vendim me numër 15 Nr.400/01-30838 për pagesën retroaktive të mjeteve financiare të ankueses për periudhën kohore prej datës 01.02.2023 deri më datë 30.06.2023

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit nuk e ka adresuar dhe nuk e ka shqyrtuar ankesën me numër 15-400/01-29567 të datës 21.06.2023 dhe Vendimin me numër 15 Nr.400/01-30838 të datës 29.06.2023 për pagesën retroaktive të mjeteve financiare të ankueses për periudhën kohore prej datës 01.02.2023 deri më datë 30.06.2023, respektivisht nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik për të proceduar dhe adresuar kërkesën për realizimin e të drejtës së pretenduar për kompensimin e pagesës për periudhën kohore sa ankuesja ka qenë Zëvendësuese e Udhëheqëses së Sektorit të Ndërtimeve në Komunën e Drenasit, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Zyrtarja e Zyrës së Personelit në Komunën e Drenasit, me mos shqyrtimin e ankesës së ankueses rrjedhimisht me rastin e mos adresimit sipas Vendimit të datës 29.06.2023 të Drejtorit të Drejtorisë për Infrastruktura Publike ka vepruar në kundërshtim me nenin 26 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: „Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit“.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesja, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht dispozitat e nenit 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, ndërsa me dispozitat e nenit 13 dhe 14 të Ligjit me numër Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorit Publik, janë përcaktuar rastet se kur nëpunësit civile kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës: *„Paga e nëpunëses/it civile përbëhet nga paga bazë, shtesat dhe kompensimet, kur shtesat dhe kompensimet janë të aplikueshme sipas këtij ligji”, dhe neni 14 „1. Paga bazë e nëpunëses/it civil është paga që përfiton nëpunësja/i civil për punën e kryer në një pozitë të caktuar apo për një klasë të caktuar dhe korrespondon me punën e kryer brenda orarit të plotë të punës gjatë një (1) muaji”.*

Andaj, duke marr parasysh rrethanat si me lartë, Kolegji konstaton se Udhëheqësja e Zyrës së Personelit në Komunën e Drenasit, është e obliguar që të ndërmarr veprime ligjore për shqyrtimin e ankesës së datës 21.06.2023 të parashtruar nga ankuesja në mënyrë që të vërtetojë drejtë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat e Ligjit me numër Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorit Publik, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren (QRK) NR. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

*Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda A.nr.1086/2023**

**Ilire MEHMETI SHAQIRI**

*[Signature]*  
**Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional**

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

*[Signature]*  
**Kryetare e Kolegjit**



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Drenasit;
- Udhëheqëses se Zyres se Personelit në Komunën e Drenasit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.